
STATUTI
I
SHOQERISE TREGTARE "ATAMEN" SH.P.K.

Sot, më datë 16.04.2021 (dymijë e njëzetënjë), ortakut i vetem themelues:

Z. Fejzi Mulita, shtetas shqiptar, i lindur në Berat, më 05.07.1955 dhe banues në Berat, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër. 034270307 dhe numer personal F50705063H,

vendosi themelimin e Shoqërise "ATAMEN" Shpk., me termat si më poshtë:

I. DISPOZITA E PERGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "ATAMEN" Shpk., rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e shoqërise, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, (në vijim Shoqëria).

NENI 1.

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt veprimtarie:

"Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike solare (fotovoltaike) dhe energjisë së erës (eolike) në Republikën e Shqipërisë dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrive e Institucioneve të Shtetit Shqiptar të gjitha miratimeve, lejeve dhe licensave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në baze të autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese të leshuara nga organet kompetente të fushës".

NENI 2

Emri dhe selia e Shoqërisë


Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj "ATAMEN" Shpk.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Adresën: Lagjja "22 Tetori", Rruga "Naim Frashëri", Pallati 80, Shkalla 11, Apartamenti 2, Berat.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë.

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i përhershëm.



NENI 4.

Regjimi juridik i Shoqërise

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomise se tregut. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo do te organizohet si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit se Themelimit, Statutit si dhe dispozitave te legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi.

Me vendim te Asamblese se Pergjitheshme, Shoqeria mundet qe te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore qe do te jene ne fuqi si dhe ne perputhje te plote me dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj. Statuti mund te ndryshoje duke ndjekur normat e mesiperme. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar. Shoqeria do te kete vulen e saj.

II. TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE.

NENI 5.

Ortaket nuk mbajne pergjegjesi per humbjet e shoqerise pervec per pjesen e pashlyer te kontributeve te tyre qe duhet te derdhen ne kapitalin fillestar.

Pasurite e krijuara nga Shoqeria gjate aktivitetit te saj jane ne pronesi te Shoqerise. Ato (pasurite) mund te tjetersohen, te jepen me qera, te lihen peng e hipoteke me miratimin e Ortakeve.

NENI 6

Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve.

Ortaket japin kontributin e tyre ne shoqeri ne para apo ne natyre, sipas menyrave dhe afateve te percaktuara ne statut. Personat pergjegjes per administrimin e shoqerise informojne te gjithë ortaket per ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare dhe, me kerkesen e tyre, duhet t'u vene ne dispozicion llogarite vjetore, perfshire llogarite e konsoliduara, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimtarise se shoqerise tregtare, raportet e organeve drejtuese apo te eksperteve kontabel te autorizuar, si dhe çdo dokument tjeter te brendshem te shoqerise, me perjashtim te rastit te sekretit tregtar, i cili eshte nje e dhene e vleresuar nga shoqeria si informacion i brendshem apo dokument qe shoqeria mbron, i cili ne rast se do t'u perhapej personave te paaautorizuar do ti shkaktonte dem te konsiderueshem interesave tregtare te shoqerise.

Ortaket kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe te shesin pjesen e tyre te kapitalit, ne perputhje me kushtet e percaktuara ne Statut dhe ne ligj.


Heqja dore nga shoqeria nuk i liron ata nga detyrimet qe ata kane ndaj shoqerise deri ne momentin e heqjes dore dhe nuk rrezikon marrjen e te ardhurave nga shoqeria te siguruar deri ne ate moment.

Gjate ushtrimit te te drejtave, ortaket veprojne, duke marre parasysh interesat e shoqerise dhe te ortakeve te tjere. Ata gezojne, te njejtat te drejta, kane te njejtat detyrime e trajtohen ne menyre te barabarte. Ortaket respektojne detyrimet qe burojne nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata perpiqen per fillimin e aktivitetit te Shoqerise sipas objektit te veprimtarise se saj.

NENI 7.

Abuzimi i ortakeve ndaj shoqerise

Ortaket, e shoqerise tregtare, qe kryejne nje apo me shume nga veprimet ose mosveprimet vijuese, pergjigjen personalisht e ne menyre solidare per detyrimet e shoqerise, me te gjithë pasurine e tyre nese:



- a) abuzojne me formen e shoqerise tregtare per arritjen e qellimeve te paligjshme;
- b) trajtojne pasurite e shoqerise tregtare si te ishin pasurite e tyre;
- c) ne çastin kur kane marre apo duhet te kishin marre dijeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise, nuk marrin masat e nevojshme, per te siguruar qe shoqeria, ne varesi te llojit te veprimtarise se ushtruar, te kete kapitale te mjaftueshme, per te permbushur detyrimet e marra persiper ndaj paleve te treta.

NENI 8.

Ndalimi i konkurrences

Ortaket nuk mund te mbajne nje pozicion drejtues apo te jene te punesuar ne shoqeri te tjera, qe ushtrojne veprimtari ne te njejtin sektor ekonomik me shoqerine. Gjithashtu, ata nuk mund te mbajne statusin e tregtarit per te ushtruar veprimtari ne kete sektor.

Ndalimi i permendur me siper mund te ndryshohet apo shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posaçem, te dhene nga asambleja e pergjithshme me 51% te votave.

Ky autorizim mbetet ne fuqi edhe pas humbjes se cilesive apo statusit te permendur ne te, por jo per nje periudhe me te gjate se nje vit pas humbjes se kesaj cilesie.

Nese ndonjeri prej ortakeve shkel ndalimin e konkurrences, shoqeria mund:

- a) ta perjashtoje ate nga shoqeria apo ta shkarkoje nga detyra;
- b) te kerkoje nderprerjen e veprimtarise konkurruese;
- c) te ngreje padi per shperblimin e demit.

Shoqeria, si alternative te ngritjes se padise per shperblimin e demit, mund t'i kerkoje secilit prej ortakeve:

1. te pranoje qe transaksionet e kryera per llogari te tij te kalohen per llogari te shoqerise;
2. t'i transferoje shoqerise te gjitha perfitimet qe ka marre nga kryerja e veprimeve per llogari te personave te trete;
3. t'i transferoje shoqerise te gjitha te drejtat e kredite, qe kane rrjedhur nga kryerja e veprimeve per llogari te personave te trete.

NENI 9.

Largimi i ortakut nga shoqeria dhe likuidimi i kuotes

Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortaketi e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij, nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij, nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise. Ortaku qe kerkon largimin, duhet te njoftoje shoqerine me shkrim, si dhe te parashtroje shkaqet e largimit. Administratoret duhet te therrasin mbledhjen e asamblese se pergjithshme menjehere pasi te kene marre dijeni per njoftimin e largimit, per te vendosur nese ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.

Ortaku ka te drejte te ngreje padi ne gjykate ndaj shoqerise per likuidimin e kuotes, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme, nese pas njoftimit te largimit asambleja e pergjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si te arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotes.

Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria, detyrohet ta demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara, nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te shkaqeve te paarsyeshme.

Ortaku qe largohet ka te drejte te ngreje padi ndaj shoqerise dhe/ose ortakeve te tjere qe shkaktuan largimin e tij dhe te kerkoje ndaj tyre, ne menyre solidare, shperblimin e demit te pesuar.

NENI 10.**Perjashtimi i ortakut**

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund t'i kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut, nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasoje e nje financimi, investimi, shtimi ne kapital dhe detyrime te tjera te parashikuara ne Statut apo nese ekzistojne shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e tij sipas parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim.

Konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar ne to , rastet kur ortakut:

- me dashje apo me pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere;
- me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj;
- perfshihet ne veprime, te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e marredhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut
- me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise.
- Gjate procedures se perjashtimit te ortakut, me kerkese te paditesit, gjykata mund te marre nje mase per sigurimin e padise, duke pezulluar te drejten e votes se ortakut, qe kerkohet te perjashtohet, si dhe te drejtat e tjera, qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, kur ajo e vlereson kete mase si te nevojshme dhe te justifikuar.
- Shoqeria ka te drejte t'i kerkoje ortakut te perjashtuar shperblimin e demit te pesuar nga veprimet, qe kane sjelle perjashtimin.
- Ortaku ka te drejte t'i kerkoje shoqerise shperblimin e demit te pesuar, nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar.
- Ortaku nuk ka te drejte t'i kerkoje shoqerise likuidimin e kuotes, nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme, por, nese shoqeria ngre ndaj tij padi per shperblim demi, ortakut ka te drejte te kompensoje cdo shume, qe do te kishte te drejte ta perfitonte ne cilesine e likuidimit te kuotes, me demin e kerkuar nga shoqeria.

III. KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE.**NENI 11.**


Aktiviteti i Shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise e te tregut. Veprimtaria ekonomike ndertohet mbi parimet e llogarise dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

NENI 12.

Kapitali fillestar i investuar nga Ortaket, perben bazen e krijimit te fondit themeltar te mjeteve te xhiros. Administratori i dorezon Ortakeve dokumentin vertetues per sasite e shumave te derdhura ne fazen e themelimit.

Vleresimi i kapitalit ne natyre eshte bere nga Ortaket Themelues ne momentin e themelimit te Shoqerise.

Ortaket mund te kryejne ne baze te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, financime per llogari te shoqerise ne perpjesetim me kuotat e zoteruara ne kapital, mbulimin e humbjeve ashtu edhe per financime jo fitimprurese.



NENI 13.**Kapitali i Shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi ne para i ortakut te vetem themelues. Ai perbehet nga 1 (nje) kuote. Kontributi ne para per 1 (nje) kuote do te kete vleren prej 10,000 (dhjetemije) Leke.

Ortaku themelues do te zoteroje kuotat ne Shoqerine "ATAMEN" Shpk., si me poshte:

- Z. Fejzi Mulita, në cilesine e Ortakut Themelues zoteron 1 (një) kuote me vlere sa 100% te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise me vlere te pergjithshme prej 10000 Leke.

Kapitali themeltar eshte derdhur ne total nga ortaku themelues ne ditën e sotme. Vleresimi dhe pagesa e kapitalit themeltar eshte kryer nga ortakut me miratimin e ketij Akti.

NENI 14.**Pronesia mbi kuotat**

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nepermjet:

- kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- shit-blerjes;
- trashegimise;
- dhurimit;
- ne çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

NENI 15.**Miratimi i Asamblese se Pergjithshme per fitimin apo kalimin e kuotave.**

Pavaresisht nga menyra e fitimit apo kalimit te kuotave, eshte i nevojshem miratimi i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Ne çdo rast, ortakut e shoqerise gezojne te drejten e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen sipas ligjit, ndryshe jane te pavlefshme.

NENI 16.

Kuotat mund te anulohen ne çdo rast me miratimin e ortakut perkates dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i rrjedhin ortakut nga zoterimi i kuotes, shuhen me anulimin e tyre.

Rastet e anulimit te kuotes do te percaktohen nga rregullore te posaçme, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve me 51% te votave.

Ndersa likuidimi i saj do te behet sipas percaktimeve te nenit 9 te ketij statuti.


NENI 17.**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet nga Asambleja e Pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund te vendoset kur e kerkojne interesat e Shoqerise duke vendosur kuotat suplementare te Ortakeve.

Asambleja e Pergjithshme, vendos per zvogelimin e kapitalit te Shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit nuk duhet te demtojte kreditorët e as te krijojte pasiguri tek ata qe kane dhene kredi para publikimit te zvogelimit te kapitalit. Ne te kunderten Gjykata e konsideron te pavlefshem kete vendim mbi kerkesen e kreditorëve.



NENI 18.**Fondet rezerve**

Shoqeria disponon lirisht mjetet e veta financiare per shlyerien e detyrimeve gjate veprimtarise se saj.

NENI 19.**Perdorimi i te ardhurave neto**

E ardhura neto qe rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bera per kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vleres se amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat qe rritin kredine per investime, pagat e shperblimet, perdoret nga Ortaket, sipas qellimeve te tyre.

NENI 20.**Bilanci, plani financiar.**

Pasuria e Shoqerise vleresohet ne bilancet e saj ne monedhe te vendit ose ne monedhe te huaj sipas vleresimit te Ortakeve ose eksperteve ne momentin e Themelimit te Shoqerise.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes. Forma e bilancit percaktohet nga Administratori ne harmoni me format e bilanceve te vendosura ne Republiken e Shqiperise. Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik te Shoqerise, te shprehur ne leke ose valute te konvertueshme. Llogaria ekonomike do te mbahet ne Shqiperi. Shkembimi i monedhes shqiptare me ate te huaj dhe anasjelltas behet sipas kursit zyrtar ose privat te kembimit.

NENI 21.**Shperndarja e fitimeve**

Ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise. Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

NENI 22.**Kufizimi i shperndarjeve te fitimeve**

Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit:

a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;

b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.


Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e mesiperme.

Kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

Administratoret, te cilet nga pakujdesia leshojne nje certifikate te pasakte te aftesise paguese, pergjigjen personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare.

Ortaket, qe kane marre nga shoqeria dividende, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve, qe u jane shperndare kur nuk eshte leshuar certifikata e aftesise paguese, ose kur, pavaresisht leshimit te certifikates, keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e



paaftesise paguese te shoqerise, ose ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishin pasur dijeni per kete gjendje.

IV. ORGANET E SHOQERISE.

NENI 23.

Asambleja e Pergjithshme

Organi themelor i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime te cilat kerkojne $\frac{3}{4}$ e votave ne rastet e meposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
4. shperndarjen e fitimeve;
5. raste te tjera te parashikuara nga ligji ose statuti;


per rastet e tjera ajo vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres si me poshte:

1. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
2. çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
3. percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
4. emerimin e shkarkimin e administratoreve;
5. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
6. percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar.
7. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
8. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
9. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

NENI 24.

Asambleja e Pergjithshme eshte e detyruar dhe me çdo kusht te mblidhet sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise ne rastet e meposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise.
- Ne rastet e parashikuara ne piken nje dhe tre me siper, perpara Asamblese se Pergjithshme paraqitet nje raport i pergatitur nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.



- Ne raste e parashikuara ne piken nje dhe tre Asamblee e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

NENI 25.

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 15 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

NENI 26.

Kuorumi i nevojshem dhe vendim-marrja

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 51% per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mbledhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me siper, asambleja mbledhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njehtin rend dite. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarrës, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Per ceshtjet e tjera, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrës.

Çdo kuote jep te drejten e nje vote. Ortaket, qe nuk jane te pranishem, mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejttat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave.

NENI 27.


Procesverbali i mbledhjes se asamblese

Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.

Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrësve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.



NENI 28.

Hetimet e posaçme

Asambleja e pergjithshme mund te vendose nisjen e nje hetimi te posaçem per parregullsitet pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare. Hetimi kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes.

Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise, apo nje vlere me te vogel te parashikuar ne statut dhe/ose cilido kreditor i shoqerise mund t'i kerkojne asamblese se pergjithshme emerimin e nje eksperti te pavarur te fushes, kur ka dyshime te bazuara per shkelje te ligjit ose te statutit ne te kundert brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per emerimin e ekspertit te pavarur, mund t'i kerkojne gjykates emerimin e ketij eksperti. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses, kerkesa e ortakeve vleresohet e refuzuar.

E drejta per te kerkuar hetim te posaçem, duhet te ushtrohet brenda 3 vjeteve nga data e regjistrimit te shoqerise tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitet e procesit te themelimit, si dhe brenda 3 vjeteve nga data e veprimit, qe konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitet e ushtrimit te veprimtarise tregtare.

Ne rastet e vendimeve te parregullta te administratorit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme ka te drejte ti kerkoje Gjykates kompetente shfuqizimin e ketyre vendimeve, kur keto perbejne shkelje te rende te ligjit apo statutit.

Ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme apo secili kreditor i shoqerise mund ti kerkoje asamblese se Pergjithshme shfuqizimin si me siper, ose ata mund te proçedojne vete perpara gjykates brenda 30 diteve nga refuzimi i asamblese per ngritjen e padise. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo kreditoreve vleresohet e refuzuar.

Proçedurat perpara gjykates ndiqen nga nje perfqesues i posaçem i shoqerise i emeruar nga Asambleja e Pergjithshme. Kreditoret apo ortaket e siperpermendur kane te drejte te kerkojne perpara gjykates zevendesimin e perfaqesuesit kur ka dyshime ne lidhje me te perfaqesimin e tij jo ne interes te shoqerise.

Rastet e hetimeve te posaçme dhe shfuqizimit te vendimeve te parregullta do te rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

V. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 29.


Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet, me te drejte riprteritjeje.

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Statuti mund te caktojte rregulla te posaçme per emerimin e administratoreve.

Administrator i Shoqerise emerohet:

- Z. Joni Veleshnja, shtetas Shqiptar, i lindur ne Tirane, me 28.09.1997 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Pasaportes me Nr.BC0009507dhe Nr. Personal J70928056N.

Shoqeria do te perfaqesohet perpara ç'do organi administrativ, gjyqesor, apo ç'do entiteti tjeter publik apo privat dhe ne marredhenie me te tretet nga Administratoret e shoqerise, te cilet



ushetrojne te drejttat e tyre ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 30.

Te drejttat dhe detyrimet e administratorit

Administratoret kane te drejte e detyrime te:

1. kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
2. perfaqesoje shoqerine tregtare;
3. kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
4. pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, te paraqese keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
5. krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
6. kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siq parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
7. raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaqme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
8. kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
9. te therrase asamblene e pergjithshme kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 31.


Shperblimi i administratoreve

Shperblimit baze te administratoreve mund t'i behen shitesa, qe mund te jene perqindje ne fitim ose te ngjashme. Shperblimet e administratoreve percaktohen me vendim te zakonshem te asamblese se pergjithshme.

Shperblimi, duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e pergjithshme mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershtatshme.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise tregtare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.



NENI 32**Ekspertet Kontabel**

Shoqeria emerion ekspertin kontabel per nje afat nje vjecar ne rastet e parashikuara nga ligji. Emerimi i tyre behet nga Asambleja e Pergjithshme.

Ekspertet kontabel jane pergjegjes per mirembajten e dokumentave te shoqerise.

Ata jane pergjegjese per demet e shkaktuara qe mund te vijne nga mbajtja e llogarive ne menyre te parregullit.

Nuk mund te emerohen si eksperte, themelues, administratore, persona qe kane lidhje gjaku deri ne shkallen e katert.

VI. MARRDHENIET E PUNES.**NENI 33.**

Marrdheniet e punes ne Shoqeri rregullohen sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar te Punes.

Punesimi ne Shoqeri realizohet me ane te kontrates individuale te punes midis Shoqerise e te punesuarve. Marrdheniet midis Shoqerise e sindikates rregullohen nepermjet kontrates kolektive te punes.

NENI 34.

Te punesuarit dhe punonjesit drejtues administrativ jane pergjegjes per demet qe i shkaktojne Shoqerise per faj te tyre dhe pergjigjen para saj civilisht.

VI. PRISHJA E SHOQERISE. LIKUJDIMI.**NENI 35.**


Shoqeria priset ne rast kur:

1. kur mbaron kohezgjatja e themelimit te saj;
2. me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
3. ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfeksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;
4. ne raste te tjera, te parashikuara ne statut;
5. ne raste te tjera, te parashikuara me ligj;
6. per cdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve, etj.;

Prishja e shoqerise regjistrohet ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit nga Administratoret.

NENI 36.**Likuidimi i shoqerise**

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.



Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga asambleja e pergjithshme. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Çdo person i interesuar, ka te drejte t'i kerkoje gjykates zevendesimin e likuiduesit, sipas vendimit te ortakeve, nese paraqet arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesit e emeruar si me siper. Kerkesa duhet te depozitohet ne gjykate brenda 30 diteve nga data e caktimit te likuiduesit.

Gjykata emerom likuiduesin, ne rastet kur shoqeria tregtare prishet me vendim gjykate.

Likuiduesit shkarkohen dhe zevendesohen me te njejtat kushte, te parashikuara ne dispozitat per emerimin e tyre.

Administratoret e shoqerise i njoftojne per regjistrim, Qendres Kombetare te Regjistrimit te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre, per te perfaqesuar shoqerine, se bashku me dokumentet perkatese. Likuiduesit depozitojne nenshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojne, gjithashtu, Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim çdo ndryshim per identitetin dhe tagrat e tyre te perfaqesimit. Emerimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Me hapjen e procedurave te likuidimit, emri i regjistruar i shoqerise ndiqet nga shenimi "ne likuidim". Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj brenda 30 diteve. Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

NENI 37.

Te drejtat e detyrimet e likuiduesve

Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

Likuiduesi mund te kryje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

NENI 38.


Bilancet

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne çastin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne çastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet miratohen nga Asambleja e Pergjithshme.

NENI 39.

Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shperndan ortakeve aktivet e mbetura, sipas te drejtave qe ata kane ne ndarjen e fitimeve, me perjashtim te rastit kur statuti parashikon radhe preference. Pasurite, qe i jane dhene shoqerise me qira apo ne perdorim, me çfaredo titulli u kthehen ortakeve. Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise.



NENI 40.**Likuidimi i thjeshtezuar**

Shoqeria mund te likuidohet nepermjet nje procedure te persheptuar, nese kjo vendoset nga te gjitha ortakët dhe kur keta deklarone perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar te gjitha marrëdhëniet me punëmarresit. Administratoret, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", njoftojne per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit vendimin per likuidimin e shoqerise, nepermjet procedures se thjeshtezuar.

Administratoret janë pergjegjes per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar. Pervec administratoreve, ortakët apo aksionaret e shoqerise pergjigjen ne menyre solidare deri ne shumat e marra.

VII. DISPOZITA TE FUNDIT.**NENI 41.**

Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

NENI 42.

Gjithçka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 43.

Ky Statut perpilohet ne 3 kopje te njejta ne gjuhen shqipe, me nga 13 (1-13) flete secila kopje dhe pasi lexohen, nenshkruhen pa verejtje nga ortakët themelues.

ORTAKU THEMELUES:

Z. Fejzi Mulita

